

UDHËZIME PARAPRAKE

**NË LIDHJE ME NDRYSHIMET KURRIKULARE NË
KUALIFIKIMET PROFESIONALE PËR VITIN
SHKOLLOR 2026-2027**

**PËR DREJTUESIT DHE MËSIMDHËNËSIT E SHKOLLAVE
PROFESIONALE**

(Në kuadrin e përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor 2026-2027)

Tiranë 2026

Ndryshimet Kurrikulare në Kualifikimet Profesionale për vitin shkollor 2026-2027

Nisur nga zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës për kualifikime profesionale, si dhe nga informacionet, komentet dhe kërkesat e marra nga shkollat profesionale në lidhje me ecurinë e zbatimit të skeletkurrikulave të Arsimit Profesional, Agjencia Kombëtare e AFP dhe Kualifikimeve (AKAFPK) ka hartuar skeletkurrikula për kualifikime profesionale të reja, si dhe ka bërë ndryshime dhe përmirësime në përmbajtjen e një pjese të skeletkurrikulave që janë në zbatim.

Në vijim jepet një informacion i përmblledhur në lidhje me këto risi. Në kuadrin e parapërgatitjeve në shkollat profesionale për fillimin e vitit të ri shkollor 2026-2027, ky informacion do të lehtësojë punën e drejtuesve të shkollave për orientimin e shkollave dhe planifikimin e burimeve të nevojshme, për plotësimin e dokumentacionit shkollor, si dhe punën e Njësive të Zhvillimit dhe Mësimdhënësve të teorisë dhe të praktikës, për të përgatitur planet e mësimdhënies.

I. Skeletkurrikula të reja të Arsimit Profesional të Nivelit III, IV dhe V të KSHK-së (10 Skeletkurrikula)

1. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Shërbime punësimi” (1-vjeçar), niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK.
2. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Mekatronikë në mjetet e rënda të transportit” (1-vjeçar), niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK.
3. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Multimedia” (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
4. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Programim” (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
5. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Zhvillim website” (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
6. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Administrim zyre” (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
7. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Rrobaqepësi” (3-vjeçar), niveli III në KSHK, referuar nivelit III në KEK.
8. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Instalime elektrike civile dhe industriale” (3-vjeçar), niveli III në KSHK, referuar nivelit III në KEK.
9. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse” (3-vjeçar), niveli III në KSHK, referuar nivelit III në KEK.
10. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Shërbime në automjete elektrike dhe hibride” (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.

II. Skeletkurrikula të rishikuara të Arsimit Profesional të Nivelit II, III dhe IV të KSHK-së (7 Skeletkurrikula)

Për vitin shkollor 2026-2027, AKAFPK, bazuar në standardet e kualifikimeve profesionale përkatëse, ka rishikuar dhe përmirësuar 7 **skeletkurrikula** të kualifikimeve profesionale të mëposhtme, për t'u zbatuar gjatë këtij viti shkollor:

1. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Ndërtim” (2-vjeçar), niveli II në KSHK, referuar nivelit II në KEK.
2. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Shërbime mjetesh transporti” (2-vjeçar), niveli II në KSHK, referuar nivelit II në KEK.
3. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Veterinari” (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
4. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore” (1-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
5. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë” (1-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
6. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Dizenjim mode” (2-vjeçar), niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK.
7. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Kontroll laboratorik i ushqimit” (1-vjeçar), niveli V në KSHK, referuar nivelit V në KEK.

III. Skeletkurrikula të Arsimit Profesional – Arsim i dyfishtë, Niveli III, IV dhe V të KSHK-së (7 Skeletkurrikula)

AKAFPK, në kuadër të zbatimit të arsimit profesional në **formën e dyfishtë** të AP, bazuar në standardet e kualifikimeve profesionale përkatëse, ka hartuar 7 **skeletkurrikula të reja** të niveleve III, IV dhe V të arsimit të dyfishtë të kualifikimeve profesionale, si më poshtë:

1. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Tregti elektronike” (E-commerce), arsim i dyfishtë (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
2. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Programim”, arsim i dyfishtë (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.
3. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Instalime dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe tensionit të lartë”, arsim i dyfishtë (3-vjeçar), niveli III në KSHK, referuar nivelit III në KEK.
4. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Mobileri dhe tapiceri”, arsim i dyfishtë (3-vjeçar), niveli III në KSHK, referuar nivelit III në KEK.
5. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Teknologji e përpunimit të brumërave”, arsim i dyfishtë, (3-vjeçar), niveli III në KSHK, referuar nivelit III në KEK.
6. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime”, arsim i dyfishtë, (3-vjeçar), niveli III në KSHK, referuar nivelit III në KEK.

7. Skeletkurrikuli për kualifikimin profesional “Riparime dhe mirëmbajtje automjete”, arsim i dyfishtë, (4-vjeçar), niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK.

Shënim: Informacione më të hollësishme do të jepen në “Udhëzuesin për drejtuesit dhe mësuesin e shkollave profesionale në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2026-2027”, që do t’ju dërgohet në fund të gushtit. Për çdo paqartësi, kontaktoni në adresën e AKAFPK-së: info.akafp@akafp.gov.al